

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA DROPULL
KËSHILLI BASHKIAK

Komisioni i Përhershëm i Ekonomisë, buxhetit, auditit të brendshëm, zhvillimit strategjik.

RAPORT VENDIMMARRJE

Nr. 5 datë 05.06.2026

Nr. 1029/ Prot

Drejtuar: Këshillit të Bashkisë

Lenda: Vendim për shqyrtimin e projekt vendimit nr. 31 datë 08.06.2026, relacionit e dokumentat shoqërues në lidhje me propozimin për “Miratimin e transferimeve të shpenzimeve në buxhetin e Bashkisë Dropull për vitin 2026”,

Analiza ligjore: Miratimin e transferimeve në shpenzimet e buxhetit të vitit 2026, është mbështetur tek të nenit 54, pika “dh”, të ligjit 139/2015 “Për Vetëqeverisjen vendore”, ligjit nr.9936, dt.26.06.2008, “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar, ligjit nr.10296, datë 08.07.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, ligjit 68/2017 “Për financat e vetqeverisjes vendore”, Udhëzimit të Ministrisë së Financave nr.9, datë 20.03.2018, “Për procedurat standarde të zbatimit të buxhetit”, të ndryshuar, Vendimit të Këshillit të Bashkisë nr.66, datë 17.12.2025, “Për miratimin e programit buxhetor afatmesëm përfundimtar 2026-2028 dhe buxhetit vjetor 2026 të Bashkisë Dropull”, i ndryshuar, Neni 60, pika “1/a” dhe “6”, e Rregullores së funksionimit të Këshillit të Bashkisë Dropull,

Situata aktuale e funksionit

Një nga investimet e miratuara në Vendimin nr.9, datë 27.02.2026, është dhe ai me titull: “Shtrim me beton i segmenteve të rrugës Poliçan-Sopik”, në vlerë 25.208.750 lek i ndarë në tre vitet 2026, 2027 dhe 2028, me vlera përkatëse 4.852.896; 10.177.927 dhe 10.177.927 lek.

Situata financiare :

Në kushtet, që investimi, i cituar më lart, ishte vazhdim i një eksperience të mbështetjes nëpërmjet ambasadës greke me çimento dhe materiale të tjera nga firma “IRAKLYS”, Fushë-Krujë, Tiranë dhe ndryshimit të kësaj eksperience dhe politike nga kjo Firmë, që transporti i materialeve të ndërtimit nuk do kryhej nga Ata, lindi nevoja e përballimit të këtij shpenzimi të konsiderueshëm nga ana e Bashkisë tonë. Nga analiza e zërave të preventivit të këtij investimi, të ripunuar nga specialistët tanë nxhinjerë, rezultoi një shtesë prej 3.100.000 lek, në zërin transport materialesh ndërtimi, si çimento, zgara hekuri, zhavor, ujë, etj (bashkangjitur preventivi i punimeve).

Këto fonde do duhet përkatësisht, të shtohet në ardhurat e Bashkisë nga Kapitulli 2, (grante të huaja) dhe në shpenzimet, sipas vendimarrjes së mësipërme, në programin buxhetor 04260 (pyje-Kullota).

P.Vendimi plotëson objektivat tona në programin buxhetor të Rrugeve rrurale, si domos per aksesin e komunitetit te zones malore te Pogonit

Drejtoria / sektori pergjegjes:

Drejtoria e Finances dhe buxhetit, pas vendimarrjes se Grupit te Menaxhimit strategjik te Bashkise.

Monitorimi dhe raportimi :

Komisioni i Ekonomise, buxhetit, auditit te brendshem, zhvillimit strategjik., dhe keshilli bashkiak, monitorojne ecurine dhe realizimin e aktit, dhe mund te kerkojne raportim periodik per zbatimin e tij.

Impakti social / grupet që preken: Ky projekt vendim, impakton zhvillimin ekonomik, zhvillimin e turizmit dhe fondit pyjor ne Njesine Administrative Pogon, aksesin me sherbime te fshatrave Skore dhe Sopik ne kufi me Greqine, me efekt ne rritjen e mireqenies se qytetareve, nëpërmjet rritjes së investimeve dhe thithjes së fondeve nga donatoret, nepermjet ndihmave me mqateriale ndertimi.

A është objekt i konsultimit publik:

Ky akt i Keshillit te Bashkise, nuk eshte objekt i konsultimit publik, para se te miratohet nga Keshilli i Bashkise.

Komisioni i Përhershëm i “Ekonomise, buxhetit, auditit te brendshem, zhvillimit strategjik.” i mbledhur me datën ____ / ____ / 2026, shqyrtoi projekt vendimit nr. ____ datë / ____ 2026, relacionit e dokumentat shoqërues në me propozimin për, “Miratimin e përdorimit të fondit të kushtëzuar të buxhetit të shtetit për emergjencat civile dhe shtesa buxhetore per vitin 2026”, paraqitur nga Kryetari i Bashkisë.

Pas shqyrtimit të projekt vendimit dhe materialeve shoqëruese,

Komisioni me shumicë votash,

VENDOSI:

1. T'i propozojë Këshillit Bashkiak:

- a) kalimin e projektaktit në Mbledhjen e Këshillit për vlerësim të mëtejshëm dhe shqyrtim
- b) miratimin e projektaktit
- c) refuzimin e miratimit të projektaktit
- d) miratimin e projekt-aktit me ndryshimet si vijon:
 - Pika 1 (një) e projekt vendimit të ndryshoje në “ -----“
 - Pika 4 (katër) e projekt vendimit të ndryshoje në “ -----“

- ✓ Tabela nr. 6 (gjashtë) e projekt vendimit të ndryshoje në "-----"
- ✓ Paragrafi 15 (pesëmbëdhjetë) i projekt vendimit të ndryshoje në "-----"

Bashkëlidhur **argumentat e vendimmarrjes dhe mendimi i pakicës** i paraqitur në procesverbalin e mbledhjes së Komisionit.

Aleksander Bobin **Kryetar i Komisionit**
(emri, mbiemri, firma)

Eljona Hana **Sekretar i Komisionit**
(emri, mbiemri, firma)

Datë 05 / 06 / 2026



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA DROPULL
KESHILLI BASHKIAK

Nr 1029/2 Prot.

Datë: 05.06.2026

PROÇES – VERBAL

J mbajtur sot më datë 05/06/2026 nga Komisioni i Ekonomisë në Buxhetin të Keshillit Bashkia Dropull.
Lënda: Vendim për shqyrtimin e projekt vendimit nr. 31 datë 08/06/2026, relacionit e dokumentat shqyrtues në lidhje me propozimin për "Miratimin e transferimeve të shpenzimeve në buxhetin e Bashkisë Dropull për vitin 2026."

Drejtuar: Keshillit të Bashkisë Komisioni i Përbërshëm për Çështjet Financiare të Buxhetit i mbledhur më datën 05/06/2026 shqyrtoi projekt vendimin nr. 31 datë 08.06.2026 relacionit e dokumentat shqyrtues në lidhje me propozimin për Miratimin e transferimeve të shpenzimeve në buxhetin e Bashkisë Dropull për vitin 2026 paraqitur nga kryetari i Bashkisë.
Për shqyrtimit të projekt vendimit dhe materialeve shqyrtuese, komisioni hartoi relacionin bashkëngjitur këtij vendimi dhe me shumicë votash vendosi:

- Ti propozojë Keshillit BashkiaK:
- a) kalimin e projektatit në mbledhjen e keshillit për vlerësim të mëtejshëm dhe shqyrtim.
 - b) miratimin e projektatit
 - ~~c) refuzimin e miratimit të projektatit~~

Sekretar komisioni

Efona Mano